



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT SHKODËR**

**Nr. Regj.Them. 176/746/1645 (00971)
Datë 10.11.2017**

**Nr. Vendimi 532
Datë 26.09.2019**

**V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër i përbërë nga gjyqtarët:

**Kryesuese
Anëtare
Anëtare**

**Hajrie MUÇMATA
Valbona VATA
Vojsava KOLA**

me sekretare seance [REDACTED], sot në Shkodër më datë 26.09.2019, në seancë gjyqësore publike, shqyrtoi çështjen civile që i përket:

PADITËS:

[REDACTED], i biri i [REDACTED], i datëlindjes [REDACTED], lindur dhe banues lagjia [REDACTED] rruga [REDACTED] Bashkia [REDACTED] përfaqësuar në gjykim nga av. [REDACTED] anëtar i Dhomës së Avokatisë [REDACTED]

I PADITUR:

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, përfaqësuar në gjykim nga juristi [REDACTED] sipas autorizimit nr.4000 prot datë 24.09.2019.

Njësia Prodhuese HEC 'Vau Dejës, në mungesë gjatë gjykimti në Gjykatën e Apelit Shkodër.

PALË E TRETË:

Komisioneri për Mbrojtjen dhe Diskriminimin, në mungesë gjatë gjykimti në Gjykatën e Apelit Shkodër.

OBJEKTI:

Konstatimin e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të marrëdhënieve të punës së paditësit Genci Troshani me Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, duke detyruar ndërgjyqësit e paditur, si më poshtë:

Të dëmshpërblejnë paditësin [REDACTED] me pagën e 12 (dymbëdhjeteë) muajve pagë, duke marre për bazë pagën mujore bruto, për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara, sipas nenit 155 të Kodit të Punës.

Të dëmshpërblejnë paditësin [REDACTED] me pagën e 3 (tre) muajve page, duke marrë për bazë pagën mujore bruto, për shkak të mosrespektimit të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, sipas nenit 144 të Kodit të Punës.

Të dëmshpërblejnë paditësin [REDACTED] me pagën 3 muaj për periudhën e afatit të njoftimit, për shkak të zgjidhjes së kontratës pa shkaqe të justifikuara, sipas neneve 147 dhe 155/1 të Kodit të Punës.

Të dëmshpërblejë paditësin [REDACTED] me pagën e 4 (katër) muajve pagë, duke marrë për bazë pagën mujore bruto, për vjetërsinë në punë mbi 8 vjet sipas nenit të Kodit të Punës.

Konstatimin e zgjidhjes së menjëhershme pa shkaqe të arsyeshme (abuzive) të marrëdhënieve të punës së paditësit [REDACTED] me KESH, duke urdhëruar ndërgjyqësit e paditur:

Të dëmshpërblejnë paditësin [REDACTED] me pagën e 12 (dymbëdhjetë) muajve, në bazë të pagës mujore bruto, për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme, sipas nenit 146/1 pikat a, b dhe d të Kodit të Punës.

Konstatimin e faktit të diskriminimit të drejtëpërdrejtë dhe viktimizimit të paditësit [REDACTED] nga veprimet e ndërgjyqësve të paditur.

Detyrimin e ndërgjyqësve të paditur për t'i paguar paditësit [REDACTED], interesin e pagës për pagesat e lartpërmendura (pikat 1/a, 1/b, 1/c dhe 2 të objektit të padisë), sipas nenit 120 të Kodit të Punës.

Detyrimin e ndërgjyqësve të paditur për pagimin e shpenzimeve gjyqësore lekë, për mbrojtjen e paditësit [REDACTED], sipas nenit 102 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Detyrimin e ndërgjyqësve të paditur për të paguar taksën mbi të ardhurat për pagesat e lartpërmendura (pikat 1/a, 1/b, 1/c, 2, 3 dhe 4 të objektit të padisë).

Dhënien këtij vendimi të fuqisë së vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile.

BAZA LIGJORE:

Nenet 1/2, 32 e vijues, 43, 47, 48, 53, 102 e vijues, 161 dhe 317 të Kodit të Procedurës Civile.

Nenet 110-160 të Kodit të Punës.

Nenet 18, 25 dhe 49/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 3 i K.E.D.NJ.-së.

Nenet 1, 12 e vijues, 34-38 të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

Nenet 419 e vijues, 625, 626 dhe 640 e vijues të Kodit Civil.

Konventa nr.111 Mbi Diskriminimin në Fushën e Punësimit dhe Profesionit (Ligji Nr. 8086, datë 13.03.1996).

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.1198 (3896) datë 02.10.2017 ka vendosur:

- Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë së paditësit [REDAKTUAR]
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 12 (dymbëdhjetë) paga mujore për zgjidhje të kontratës individuale të punës në mënyrë të menjëhershme, të pajustificuar dhe në kohë të papërshtatshme sipas nenit 155/3 të Kodit të Punës.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 3 (tre) paga mujore për mosrespektim të afatit 3 (tre) mujor të njoftimit sipas nenit 143, pika 1 e K.Punës.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 3 (tre) paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës individuale të punës sipas nenit 144 të K.Punës.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 4 (katër) paga mujore shpërblim për vjetërsi në punë sipas nenit 145 të K.Punës.
- Si pagë referuese do të merret paga që ekzistonte në përfundimin e marrëdhënies së punës, sipas vërtetimit datë 22.02.2017, në masën e pagës bruto mujore 60.419 (gjashtëdhjetë mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.
- Rrëzimin e kërkesë padisë për kërkimet e tjera të padisë.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Kundër këtij vendimi palët mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër brenda 15 ditëve duke filluar nga e nesërmja e shpalljes.

Kundër këtij vendimi, më datë 16.10.2018, ka paraqitur ankim Korporata Elektroenergjetike Shqiptare duke parashtruar këto shkaqe për pranimin e ankimit:

- Nuk jemi dakort me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi kjo gjykatë ka keqinterpretuar faktet dhe provat e depozituara në gjykatë;

- KESH sh.a., ka provuar gjatë gjykimit se kontrata objekt gjykimi nuk është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme;
- Në asnjë moment të procesit nuk është hetuar nga gjykata nëse është diskutuar nga palët dhe nuk është provuar nga paditësi me akte dhe prova se jemi para zgjidhjes së kontratës në kohë të papërshtatshme referuar nenit 147 të K.Punës;
- Gjykata gabon kur llogarit kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës mes palëve, gjykata shprehet se marrëdhënia e punës ka zgjatur 9 vite kur në fakt është lehtësisht e evidentueshme se kjo marrëdhënie ka zgjatur 7 vite e 11 muaj;
- Në lidhje me dëshmipërblimin që pala paditëse pretendon për mosrespektim të afateve të njoftimit referuar nenit 143 të K.Punës, pala paditëse kishte më shumë se 5 vjet marrëdhënie pune, KESH sh.a., njeh dhe respekton afatin 3 mujor të njoftimit dhe shprehet se marrëdhëniet financiare mes palëve do të përfundojnë në datën 15.08.2016 pra 3 muaj pas njoftimit mbi zgjidhjen përfundimtare të zgjidhjes së marrëdhënies;
- Në respektim të afateve të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Punës me datën 09.05.2016 është mbajtur takim në orën 09:30 mes përfaqësuesit të punëdhënësit dhe punonjësit dhe punëmarrësi ka marrë pjesë në takim dhe refuzonte të nënshkruante apo të shprehte me shkrim pretendimet e tij;
- Duke patur barrën e provës në kërkimin e paraqitur pala paditëse nuk ka mundur të provojë me asnjë fakt apo provë, mbi ekzistencën e ndonjë rasti të parashikuar në nenin 146 të K.Punës.

Në përfundim të ankimit ka kërkuar: *Ndryshimin e vendimit nr.1198 (3896) datë 02.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.*

GJYKATA E APELIT SHKODËR,

pasi dëgjoji relatimin e gjyqtares Hajrie Muçmata,

pasi dëgjoji av. [REDAKTUAR] përfaqësues i paditësit, që kërkoj: Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;

dëgjoji përfaqësuesin e palës së paditur Korporata Elektroenergjetike Shqiptare që kërkoj sipas ankimit: Ndryshimin e vendimit nr.1198 (3896) datë 02.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e kërkesëpadisë;

në mungesë Njësia Prodhuese HEC Vau Dejës dhe Komisioneri për Mbrojtjen dhe Diskriminimin, të cilët kishin dijeni rregullisht për gjykimin dhe nuk paraqitën asnjë shkak të ligjshëm për të justifikuar mungesën e tyre;

si dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

Në Gjykatën e Apelit Shkodër ka ardhur për shqyrim ankimi i paraqitur nga pala e paditur KESH sh.a., ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 1198 (3896) datë 02.10.2017 me të cilin është pranuar pjesërisht kërkesë padinë e paditësit [REDAKTUAR]

Nga shqyrtimi gjyqësor i bërë gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka rezultuar e provuar se:

Paditësi [REDAKTUAR] ka filluar punë në Ndërmarrjen Hec Vau Dejes në datën 15.09.2008, dhe ka punuar deri në datën 15.08.2016, me detyrë "Droselist". Paditësi ka punuar pranë kësaj njësie prodhuese deri në datën 15.08.2016, ku janë ndërprerë marrëdhëniet e punës përfundimisht për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës nga pala e paditur.

Sipas shënimeve në librezën e punës, shkak i zgjidhjes është se shërbimet dhe puna e tij nuk janë më të nevojshme, Ky fakt provohet nëpërmjet shënimeve të pasqyruara në librezën e punës të paditësit.

Paditësi [REDAKTUAR] ka qenë anetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë nga viti 2013 fakt i cili u provua gjatë gjykimit me vertetimin e lëshuar nga kryetari i kësaj force politike deri me datë 13.10.2016.

Pala e paditur me shkresën me nr.3747/1 prot, datë 28.04.2016 me lëndë "*Njoftim mbi fillimin e bisedimeve për zgjidhjen e kontratës së punës*", ka njoftuar paditësin për fillimin e procedurave të zgjidhjes së kontratës së punës, sipas nenit 144 të K.Punës, duke e njoftuar paditësin që të paraqitet për bisedime me Zyrën e Departamentit të Burimeve Njerëzore 72 orë pas marrjes së njoftimit nga paditësi. Referuar përmbajtjes së kësaj shkrese arsyeja e fillimit të bisedimeve për zgjidhjen e kontratës së punës ka qenë propozimi i bërë nga Njësia Hec Vau Dejës që shërbimet dhe puna e ofruar nga ky punonjës nuk janë më të nevojshme".

Në vijim të procedurës sa më sipër takimi midis palëve, punëdhënësit dhe punëmarrësit është realizuar në datën 09.05.2016 takimi sipas procesverbalit me nr.3747/2 datë 09.05.2016, procesverbal "*I takimit të realizuar për zgjidhjen e kontratës së punës*", i cili nuk është nënshkruar nga punëmarrësi [REDAKTUAR] por vetëm nga përfaqësues i punëdhënësit.

Pas realizimit të takimit pala e paditur me shkresën me nr.3747/3 prot, datë 12.05.2016, me lëndë "*Njoftim mbi zgjidhjen përfundimtare të kontratës së punës*", ka njoftuar paditësin për zgjidhjen në mënyrë të menjëhershme dhe për shkaqe të justifikuara të kontratës së punës, ku është përcaktuar se marrëdhëniet e punës dhe ato financiare ndërpriten në datën 15.08.2016. Njëkohësisht në të njëjtën shkresë është përcaktuar se punëmarrësi përfiton edhe pagesën që i takon për pushimet e pakryera sipas nenit 154 të K.Punës.

Ndodhur në kushtet sa më sipër, paditësi duke pretenduar se zgjidhja e kontratës individuale të punës është kryer nga pala e paditur për shkaqe të pajustificuara dhe në mënyrë të menjëhershme, pa respektuar afatin e njoftimit dhe procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës, duke e zgjidhur kontratën edhe në kohë të papërshtatshme, i është drejtuar gjykatës me padi duke kërkuar dëmshpërblimet përkatëse.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.1198 (3896) datë 02.10.2017 ka vendosur:

- *Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë së paditësit [REDAKTUAR]*
- *Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 12 (dymbëdhjetë) paga mujore për zgjidhje të kontratës individuale të punës në*

mënyrë të menjëhershme, të pajustificuar dhe në kohë të papërshtatshme sipas nenit 155/3 të Kodit të Punës.

- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 3 (tre) paga mujore për mosrespektim të afatit 3 (tre) mujor të njoftimit sipas nenit 143, pika 1 e K.Punës.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 3 (tre) paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës individuale të punës sipas nenit 144 të K.Punës.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 4 (katër) paga mujore shpërblim për vjetërsi në punë sipas nenit 145 të K.Punës.
- Si pagë referuese do të merret paga që ekzistonte në përfundimin e marrëdhënies së punës, sipas vërtetimit datë 22.02.2017, në masën e pagës bruto mujore 60.419 (gjashtëdhjetë mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.
- Rrëzimin e kërkesë padisë për kërkimet e tjera të padisë.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Kundër këtij vendimi palët mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër brenda 15 ditëve duke filluar nga e nesërmja e shpalljes.

Kundër vendimit, ka paraqitur ankim pala e paditur, duke parashtruar shkaqet e relatuara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Në analizë të shkaqeve të parashtruara në ankim nga pala e paditur, pretendimeve përpara kësaj gjykate nga palët ndërgjyqëse, Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi nr. 1198 (3896) datë 02.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është i drejtë dhe i bazuar në prova dhe në ligj dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi pasi me shkaqet e ngritura në ankim nuk mund të çenohet.

Së pari: Largimi nga puna i paditësit [REDAKTUAR] është bërë pa shkaqe të justifikuara, pasi nuk ka rezultuar që paditësi të ketë kryer ndonjë shkelje të rëndë të detyrimeve kontraktuale që burojnë nga kontrata e punës. Me të drejtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka arsyetuar se nuk jemi para zgjidhjes së justifikuar të kontratës së punës për sa kohë që nuk rezulton që paditësi të ketë kryer ndonjë faj të rëndë.

Gjykata e Apelit çmon se kontrata e punës mes palëve ndërgjyqëse ka qenë pa afat të përcaktuar, e sa kohë punëmarrësi nuk kryen shkelje të rënda të disiplinës në punë me faj, apo shkelje të lehta, të përsëritura, ka garancinë për vijimësinë e marrëdhënieve të punës.

Pikërisht për këtë shkak, për përfundim të marrëdhënieve të punës në mënyrë të njëanshme nga punëdhënësi nuk përjashton të drejtën e dëmshpërblimit të punëmarrësit për zgjidhje të pajustificuar të kontratës së punës. Në këtë rast, për të zgjidhur këtë pretendim gjykata referon drejtëpërsëdrejti në dispozitat e Kodit të Punës, në nenet 153 – 155 të tij. Paditësi [REDAKTUAR] ka përmbushur të gjitha detyrimet që i rridhnin nga kontrata e punës, prandaj çdo shkak tjetër, i parashikuar në kontratë për përfundimin e marrëdhënieve të punës është i paligjshëm. Prandaj, ndërprerja e marrëdhënieve të punës pa ndonjë shkak të ligjshëm është abuziv dhe i pavlefshëm, prandaj me të drejtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur të dëmshpërblejë paditësin.

Gjykata e Apelit e gjen të bazuar vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër sa i përket masës së dëmshpërblimit për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

Ligjvënësi ka përcaktuar dëmshpërblimin maksimal që mund të jepet në këto raste, prej 12 muaj pagë dhe e ka lënë në diskrecion të gjykatës të përcaktojë rast pas rasti, masën e përshtatshme të dëmshpërblimit dhe gjykata gjatë dhënies së këtij dëmshpërblimi duhet të ketë parasysh:

- Kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit që në rastin konkret rezulton që paditësi ka një vjetërsi në pune e cila ka filluar që në vitin 2008 pa ndërprerje pranë anës së paditur por se vetëm ka ndryshuar pozicionet.
- Moshën, kushtet familjare dhe arsimimi i punëmarrësit e konkretisht faktin që ai aktualisht rreth 47 vjeç, është i martuar dhe është kryefamiljar në familjen e tij.
- Mundësitë e punëmarrësit për të siguruar një tjetër punë pasi në kushtet e ekonomisë së tregut si dhe referuar situatës ekonomike dhe moshës së tij, këto mundësi janë të pakta.
- Arsyet e përfundimit të marrëdhënieve të punës, pasi gjatë gjithë periudhës së punës së tij pranë anës së paditur nuk rezultoi që ai të ketë marrë ndonjë tërheqje vëmendje apo masë tjetër disiplinore.

Meqenëse bëhet fjalë për një dëmshpërblim që do jepet nga punëdhënësi, rol parësor në përcaktimin e masës së dëmshpërblimit zë kontributi që ka dhënë pranë tij me punën e realizuar, punëmarrësi dhe Gjykata e Apelit e gjen të bazuar vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, kjo dhe në referim të vendimit nr. 19, datë 15.11.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka arsyetuar se:

“Në praktikë është pranuar se masa e dëmshpërblimit, që sipas ligjit paracaktohet në mënyrë të përafërt, sipas diskrecionit të gjykatës, për shkak të pamundësisë objektive për vlerësimin e saktë të saj, si rregull, nuk përbën objekt rivlerësimi të mëvonshëm. Megjithatë, në këto raste gjykatës nuk i lejohet të caktojë një dëmshpërblim që kapërcen kriteret e vendosura në ligj”.

Së dyti: Gjykata e Apelit e gjen të bazuar vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për pranimin e kërkesës së paditësit për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, pra duke vepruar në konform me nenin 144 të Kodit të Punës.

Konkretisht, neni 144 i Kodit të Punës ka përcaktuar se:

5) Punëdhënësi, që nuk respekton procedurën e përcaktuar në këtë nen, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim prej dy muajsh pagë, që i shtohet dëmshpërblimeve të tjera të mundshme. Zgjidhja e kontratës në kundërshtim me këtë dispozitë mbetet e vlefshme.

5/1. I takon punëdhënësit të vërtetojë që procedura e përcaktuar nga ky nen është respektuar.

Pala e paditur KESH sh.a në respektim të nenit 144 të atij kodi, ka kryer përpjekje për të respektuar hapat proceduralë në vijim:

1. Realizimin e një takimi me punëmarrësen duke e njoftuar të paktën 72 orë para me shkrim për takimin; Në rastin konkret pala e paditur ka paraqitur një shkresë me nr. 3747/1 datë 28.04.2016 me lëndë “Njoftimin mbi fillimin e bisedimeve për zgjidhjen e kontratës së punës” por nuk ka arritur ta provojë që kjo shkresë i është njoftuar paditësit dhe ai ka patur njoftim të rregullt për ekzistencën e saj.

2. *Njoftimin e arsyeve që shpjen në përfundimin e kontratës së punës si dhe t'i japë mundësi punëmarrëses të shprehet; Nga pala e paditur me shkresën me nr.13747/2 datë 09.05.2016 me titull "Procesverbal i takimit për zgjidhjen e kontratës së punës" është pretenduar se paditësi ka marrë pjesë në këtë takim por rezulton që ky procesverbal të mos jetë nënshkruar nga ana e tij dhe nuk ka prova shkresore për të provuar faktin që ai ka qenë i pranishëm në këtë takim.*
3. *Zgjidhja e marrëdhënieve të punës duhet të njoftohet brenda afatit kohor 48 orë deri në 1 javë nga data e realizimit të takimit; Në rastin konkret takimi me paditësin është pretenduar se është bërë me datë 09.05.2016, ndërsa shkresa për njoftimin për zgjidhjen përfundimtare të marrëdhënieve të punës është bërë me datë 12.05.2016 pra më shumë se 48 orë.*

Pra sa më sipër Gjykata e Apelit vlerëson se me të drejtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka pranuar kërkesën e paditësit për detyrimin e palës së paditur për mosrespektim të afateve të njoftimit dhe dëmshpërblimin e tij në masën e 3 muajve pagë, dëmshpërblim i cili u bashkangjitet dhe shpërblimeve të tjera.

Së treti: Gjykata e Apelit çmon se nga pala e paditur nuk është respektuar procedura e njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës konform nenit 143 të K.Punës pasi nga pala e paditur është zgjidhur kontrata me efekt të menjëhershëm dhe në këto kushte me të drejtë ka vlerësuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër se duke qenë se nuk është respektuar kjo procedurë duhet të dëmshpërblehet paditësi me pagën e 3 muajve, pagë e cila duhet tu shtohet dëmshpërblimeve të tjera.

Së treti: Gjykata e Apelit e gjen të bazuar vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, edhe përsa i përket masës së dëmshpërblimit për vjetërsi. Shpërblimi për vjetërsi në punë (*edhe nga vetë termi*) nuk është sanksion ndaj punëdhënësit, por është një formë vlerësimi material për punëmarrësin, një përfitim që duhet t'i paguhet punëmarrësit për kontributin që ka dhënë për punëdhënësin dhe i cili nuk jepet në raste përjashtimore, parashikuar në nenin 145 të Kodit të Punës. Kontributi ka të bëjë me pjesëmarrjen e punëmarrësit në aktivitetin e punëdhënësit, duke dhënë ndihmën e tij në forma të ndryshme për të kryer një punë të dobishme në favor të punëdhënësit, me vënien nga ana e punëmarrësit të aftësive të tij profesionale, mendore e fizike në shërbim të punëdhënësit. Në këtë vështrim, është e natyrshme që punëmarrësi të përfitojë shpërblimin për vjetërsi në punë kur plotësohen kushtet e specifikuar nga neni 145 i Kodit të Punës. Në të njëjtën logjikë shkon edhe neni 152 i po këtij Kodi pasi shpërblimi për vjetërsi në punë (si një përfitim për punëmarrësin) zbatohet në mënyrë subsidare, duke iu shtuar dëmshpërblimeve të tjera (nëse janë të zbatueshme), dhe nuk kushtëzohet nga mënyra e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, me përjashtim të rastit kur punëmarrësi largohet nga puna në mënyrë të menjëhershme dhe të justifikuar apo kur ai vetë, me vullnetin e tij i jep fund marrëdhënies së punës. Në këtë kuptim, në çdo rast kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye që kanë të bëjnë me punëdhënësin dhe ekzistojnë kushtet e nenit 145 të Kodit të Punës, punëmarrësi përfiton shpërblimin për vjetërsi në punë.

Kodi i Punës në nenin 145 përcakton:

Punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsi, kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës kanë zgjatur jo më pak se tre vjet. Punëmarrësi e humb të drejtën e shpërblimit për vjetërsi, nëse është pushuar me efekt të menjëhershëm për shkaqe të arsyeshme.

Shpërblimi për vjetërsi është të paktën sa paga e një 15 –ditëshi, mbi çdo vit pune të plotë, që llogaritet në bazë të pagës që ekziston në përfundim të marrëdhënieve të punës... .

Shpërblimi për vjetërsi i shtohet shpërblimi që jepet në rastin e zgjidhjes së kontratës pa shkaqe të arsyeshme ose të zgjidhjes së menjëhershme pa shkaqe të arsyeshme.

Në rastin konkret është provuar që paditësi [REDAKTUAR] ka punuar pa ndërprerje pranë palës së paditur KESH sh.a., për një periudhë kohore që nga viti 2008 deri në ditën e largimit nga puna në vitin 2016, prej 8 vjetësh, pra në interpretim dhe zbatim të nenit 145, duke qenë se për paditësin jemi në rastin e zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës ë punës ky dëmshpërblim duhet të jetë të paktën 4 (katër) paga mujore dëmshpërblim ky që i shtohet dëmshpërblimeve të dhëna nga gjykata.

Në këto rrethana, Gjykata e Apelit konkludon se vendimi nr. 1198 (3896) datë 02.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër duhet të lihet në fuqi, pasi me shkaqet e ngritura në ankim prej palës së paditur, nuk mund të cenohet ky vendim.

PËR KËTO ARSYE

Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër, bazuar në nenin 466 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI

Lënen në fuqi të vendimit nr.1198 (3896) date 02.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për pikat 1, 2, 6,7 dhe 8 të tij.

Ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesë padisë për kërkimet e tjera të tij.

Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda afatit 30 ditor, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunimit të vendimit.

Shkodër, më 26.09.2019

ANËTARE
Vojsava KOLA
d.v.

ANËTARE
Valbona VATA
d.v.

KRYESUESE
Hajrie MUÇMATA
d.v.

Vertetohet njesia me origjinalin
KRYESEKRETARE
MIMOZA NDOCI

